

Të dhënat paraprake tregojnë se vaksinat kundër COVID-19 mbeten efektive kundër sëmundjes së rëndë dhe hospitalizimit të shkaktuara nga varianti Omicron

Lajme 11/01/2022

Agjencia Europiane e barnave (EMA) vazhdon të monitorojë të dhënat e reja për efektivitetin e vaksinave kundër COVID-19, duke përfshirë sëmundjen e shkaktuar nga varianti Omicron i cili tani po përhapet me shpejtësi në të gjithë Unionin Europian (UE).

Megjithëse Omicron duket të jetë më infektues se variantet e tjera, studimet nga Afrika e Jugut, Mbretëria e Bashkuar dhe disa vende të UE-së tregojnë një rrezik më të ulët nga hospitalizimi pas infektimit me Omicron; bazuar në këto studime, rreziku aktualisht vlerësohet të jetë midis një të tretës dhe gjysmës së rrezikut me variantin Delta.

Rezultatet nga studimet e publikuara së fundmi tregojnë se efektiviteti i vaksinës kundër sëmundjes simptomatike është më i ulët për Omicron sesa për variantet e tjera dhe me kalimin e kohës dobësohet. Si rezultat, më shumë njerëz të vaksinuar ka të ngjarë të zhvillojnë sëmundjen e shkaktuar nga Omicron.

Megjithatë, këto studime tregojnë gjithashtu se vaksinimi vazhdon të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje kundër sëmundjes së rëndë dhe hospitalizimit të lidhur me variantin Omicron. Të dhënat e fundit, që përfshijnë të dhënat e efektivitetit në praktikën e përgjithshme (real world data), sugjerojnë gjithashtu se njerëzit që kanë marrë dozën përforcuese (doza booster) janë më të mbrojtur se ata që kanë përfunduar vetëm vaksinimin primar dhe nuk e kanë marrë dozën përforcuese.

Të dhënat nga Afrika e Jugut tregojnë se njerëzit që kanë marrë dy doza të vaksinës COVID-19 kanë deri në 70% mbrojtje nga hospitalizimi.¹ Të dhëna të ngjashme nga Mbretëria e Bashkuar tregojnë që edhe pse mbrojtja bie disa muaj pas vaksinimit, mbrojtja nga hospitalizimi rritet përsëri në 90% pas marrjes së dozës përforcuese.²

EMA do të vazhdojë vlerësimin e të dhënave për efektivitetin e vaksinës dhe ashpërsinë e sëmundjes, si dhe të dhënat e lidhura me variantet qarkulluese dhe ekspozimin natyror ndaj Omicron-it, pasi ato bëhen të disponueshme. Rezultati i këtyre vlerësimeve mund të ndikojë në strategjitë e ardhshme të vaksinimit të rekomanduara nga ekspertë në shtetet anëtare të UE/Hapësirës Europiane Ekonomike.

EMA thekson se vaksinimi mbetet pjesë esenciale e qasjes për të luftuar pandeminë në vazhdim. Në përputhje me rekomandimet e autoriteteve kombëtare, duhet të vazhdojnë përpjekjet për të rritur vaksinimin e plotë tek individët që aktualisht janë të pavaksinuar ose pjesërisht të vaksinuar dhe për të përshpejtuar dhënien e dozave përforcuese të vaksinave.

¹E Collie S, Moultrie H, Bekker L, Gray G. Effectiveness of BNT162b2 Vaccine against Omicron Variant in South Africa. N Engl J Med 2021. December 29, 2021.

²UK Health Security Agency. SARS-CoV-2 variants of concern and variants under investigation in England. Technical briefing: Update on hospitalisation and vaccine effectiveness for Omicron VOC-21NOV-01 (B.1.1.529). December 31, 2021

Më shumë informata mund të gjeni në vegzën: <https://www.ema.europa.eu/en/news/preliminary-data-indicate-covid-19-vaccines-remain-effective-against-severe-disease-hospitalisation>